

## **Sondazhi Kombëtar i Studentëve**

**16 Prill-05 Maj 2019**

Sondazhi Kombëtar i Studentëve është proces i cili ka në qendër studentin dhe ka si qëllim kryesor vlerësimin dhe matjen e cilësisë në arsimin e lartë duke vlerësuar performancë e Institucioneve të Arsimit të Lartë në veprimtarinë e mësimdhënies, mësimnxënies, kompetencave dhe mbështetjes ndaj studentëve. Ky sondazh fillon në 16 Prill 2019 dhe përfundon në 5 Maj 2019.

SKS-ja është një instrument kyç në sigurimin e jashtëm të cilësisë dhe matjen e perceptimit të kënaqshmërisë së studentëve me cilësinë e shërbimit akademik që ata marrin në IAL-të ku ata studiojnë. Të dhënat e përftuara nga ky sondazh do të përdoren për formësimin e politikave publike të arsimit të lartë, identifikimin e pikave të dobëta dhe ndërhyrjeve potenciale që duhen bërë për t'i adresuar ato, për informimin e studentëve të ardhshëm mbi perceptimin që kanë studentët aktual mbi institucionin dhe programin e studimit ku ata synojnë të regjistrohen.

Sondazhi Organizohet dhe monitorohet nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL) në bashkëpunim me institucionet e arsimit të lartë.